



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Nr. 435 Prot.

### VENDIM

Nr. 57 Date 21/01/2018

"Për marrje të nismës për hartimin e P.D.V. në njesinë me kod 1/55 sipas P.P.V."

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit te Bashkisë Elbasan dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin territorit", i ndryshuar me ligjin 73/2015 date 09/07/2015, në VKM nr. 408 date 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, në VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", VKM nr. 1096 date 28.12.2015 "Per miratimin e rregullave, kushteve, procedurave përdorimin dhe menaxhimin e hapsirës publike" dhe me PPV të mirattuar me vendim te KKT nr.1 date 2912.2016, dhe interesit të Bashkisë Elbasan:

*Për hartim e PDV-së me nismë publike sipas P.P.V. të Bashkisë Elbasan, në njesinë strukturore me kod 1/55. "Qendra Administrative e qytetit":*

#### VENDOSA:

- Të marr **nismën** për hartimin, e **P.D.V.** për njesinë strukturore me kod 1/55, "Qendra Administrative e qytetit", qe kufizohet nga rrugjet «Qemal Stafa», «Thoma Kalefis», «Labnati» dhe rruga «Ali Jolldashi». Njësia, që do të studiohet, referuar përcaktimeve në pasaportat e dokumentit të Rregullores Vendore të Planifikimit, figuron me sipërfaqe 36.075,9 m<sup>2</sup>, perimetër 859,3 ml.
- Të urdhërojë Drejtorinë e Planifikimit të Territorit për hartimin e **P.D.V.** për njesinë me kod 1/55 "Qendra Administrative e qytetit", sipas parashikimeve të Relacionit Shoqëruar të Njësies bashkangjitur këtij njoftimi.
- Të urdhërojë Drejtorinë e Detyrave të Projektit, Standartizimit dhe Arzhomimit të Tokave për hartimin e reliefit topografik të zonës për njësinë me kod 1/55 "Qendra Administrative e qytetit".
- Gjatë periudhës së hartimit të PDV, deri në miratimin e saj, ndërtime të reja nuk do të lejohen. Ngarkohet me hartimin, ndjekjen dhe kontrollin e kësaj P.D.V., Drejtoria e përgjithshme e Shërbimeve Operacionale, Drejtoria e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Elbasan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË



Qazim Sejdini

# **Relacion Shoqërues për Nismën për Hartimin e PDV për Njësinë Strukturore 1/55**

## **Përbajtja**

1- Nevoja për Hartimin e PDV në njësinë Strukturore 1/55 .....	3
2- Baza Ligjore për hartimin e PDV .....	4-6
3- Parashikimet e PPV për njësinë strukturore 1/55 .....	8
4- Gjendja e Pronësisë dhe Informaliteti .....	9
5- Plani i Veprimeve për Hartimin e PDV .....	10
6- Buxheti per për Hartimin e PDV .....	10
7- Grupi i punes per hartimin e PDV .....	11


Harta 1- Njësia Strukturore 1/55 ortofoto .....	3
Harta 2- Harta e perdonimit te tokes njesia 1/55 .....	7
Harta 3- Harta sipas sistemit GIS njesia 1/55 .....	7
Tabela 1- Parashikimet e PPV për njësinë Strukturore 1/55 .....	8
Tabela 2- Gjendja e Pronësisë në Njësi .....	9

## 1- Nevoja për Hartimin e PDV në njësinë Strukturore 1/55

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan ka përcaktuar si zona me intensitet të lartë ndërtimi njësítë strukturore që ndodhen në qendër të qytetit, ku dhe shtrihen zyrat kryesore të administratës publike mbi të gjitha Bashkia, Prefektura, Biblioteka dhe Arkiva e qytetit dhe që kufizohet nga rrugët «Qemal Stafa»; «Thoma Kalefi»; «Labinoti» dhe rruga «Ali Jollashi». Kjo njësi strukturore karakterizohet dhe nga banesa përgjithësisht të ulta, një apo dy kat, në pjesën jugore ku ka dhe përqëndrim më të madh zona e banimit. Nevoja per hartimin e kesaj PDV si një ndër planet e detajuara vendore, vjen për shkak të mungesës së hapësirave të mjafueshme të zyrave të administratës së bashkisë e cila aktualisht është e ndarë në objekte të ndryshme për të mbuluar shërbimin për qytetarët.

Mënyra se si është e organizuar zona nuk ofron hapësira të mjafueshme për gjelbërim, por shfrytëzohet shumë mirë parku i qendrës ngjitur më ketë njësi. Duke qenë se, që në krijimin e saj nuk ka patur ndërhyrje për të përballuar kapacitetin aktual të shërbimeve që ofron Bashkia Elbasan, e cila me ndarjen e re administrative, është rritur ndjeshëm dhe numri i popullsisë për të cilet kjo bashki ofron shërbime, për këtë arsy është mëse e domosdoshme hartimi i PDV-së në këtë zonë dhe për pasojë edhe të jetë një ndër Planet e Detajuara Vendore, të cilat do të hartoher që në fillim me iniciative të vetë Kryetarit te Bashkisë. Në këtë zonë, sidomos në zonën e godinës së Bashkisë, meqenëse një pjesë e konsiderueshme e pronave janë të sajat, është menduar të zbatohet parmeriteti publik-privat për ndërtimin e godinës së re të bashkisë. Kjo njësi është parashikuar në PPV, që të zhvillohet nëpërmjet PDV, pra si njëdhojë hartimi i PDV shihet si një hap fillestar për vijueshmérinë e projektit.

Harta 1- Njësia Strukturore 1/55



## **2- Baza Ligjore për hartimin e PDV**

Baza ligjore për hartimin e PDV është Ligji 107/2014, dt 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit. Bazuar në pikat 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 12, 14 dhe 15 të nenit 22 të ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, PDV:

- Planet e detajuara vendore hartohen me nismë publike ose private në zona të cilat janë:
  - a. një njësi strukturore;
  - b. disa njësi strukturore bashkë;
  - c. çdo zonë me prioritet për zhvillim, e përcaktuar si e tillë në planin e përgjithshëm vendor të territorit.
- Planet e detajuara vendore kanë për qëllim:
  - a) zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e një zone;
  - b) rigjenerimin/ripërtëritjen e një zone kryesish urbane;
  - c) ndërtimin e infrastrukturave publike.
- Planet e detajuara vendore kanë për objekt nëndarjen dhe/ose bashkimin për qëllim zhvillimi.
- Kryetari i bashkisë merr vendimin mbi miratimin e planit të detajuar vendor brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar pulit e interesuara përmes një e më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe kryen takime publike me ta, në rast se kërkohet.
- Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit. - Në rast se ka kundërshtime si më sipër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore organizon takime publike me palët e interesuara, shqyrtion vërejtjet ose propozimet përkatëse dhe vlerëson reflektimin e tyre në planin e detajuar vendor.
- Në përfundim të procesit, kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara.
- Plani i detajuar vendor regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluaqitshme si buxhet për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nënndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksioni vetëm pasi të jenë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluaqitshme, me kërkesë të zhvilluesit.
- Dokumenti i planit të detajuar vendor shoqërohet nga një dokument teknik i shpërndarjes së balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, së mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e matur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.
- Përfitimet e autoritetit të planifikimit nga të drejtat për zhvillim dhe vlera e matur e tokës përdoren për ndërtimin ose financimin e infrastrukturave publike, kryesish në zonën ku janë përfstuar.

Bazuar në nenin 70, të VKM “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”:

- Procesi i hartimit PDV-së nis me botimin e njoftimit të bashkisë në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimmarrjes së kryetarit të njësisë vendore.
- Njoftimi për nisjen e hartimit të PDV-së përmban:
  - o Kodin e Njësisë, të paracaktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor, shoqëruar me përcaktimet për zhvillimin e njësisë që rrjedhin nga ky plan.

- Deklaratën e dakordësisë së pronarëve që kanë në pronësi jo më pak se 51% të sipërfaqes së njësisë, në rastin e hartimit të PDV-së me nismë private, në përputhje me pikën 5, të nenit 22 të ligjit.
- Sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës për planifikimin, mund të përbajë edhe:
  - ✓ buxhetin për hartimin e PDV-së, kur është me nismë publike;
  - ✓ planin e veprimit për hartimin e PDV-së.
- Këshillimi i PDV-së, në rastet sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 22 të ligjit, kryhet përmes botimit të dokumentit në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe, në rast se kërkohet, përmes organizimit të takimeve publike me ta.
- Në çdo rast, dokumentacioni i plotë përfundimtar i PDV-së botohet në regjistër dhe qëndron i disponueshëm për këshillim të paktën për 30 (tridhjetë) ditë përpara vendimmarrjes së kryetarit.

Ndërkohë bazuar në nenin 71, përbajtja e dokumentit të PDV-së është:


1. Dokumenti i planit të detauar vendor (PDV) hartohet në përputhje me dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor, dokumentet e planifikimit vendor sektorial dhe legjislacionin në fuqi.
2. Plani i detauar vendor përmban të paktën:
  - a. planin e përcaktimeve territoriale, i shprehur në relacion dhe harta shoqëruese për pikat e mëposhtme:
    - i) analizën që paraprin përcaktimet territoriale;
    - ii) përcaktimin e nënënjësive brenda njësisë në përputhje me nenin 78 të kësaj rregulloreje;
    - iii) përcaktimet për përdorimin e tokës për çdo nënënjësi në nënkategori dhe funksione sipas kësaj rregulloreje;
    - iv) përcaktimet e infrastrukturave teknike, duke përfshirë ato të transportit, energjisë, telekomunikacionit dhe ujësjellës-kanalizimeve;
    - v) përcaktimet e kushteve të zhvillimit për nënënjësitë, sipas rastit dhe/ose për parcelat;
    - vi) përcaktimet për zonat/objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore, bazuar në legjislacionin përkatesë në fuqi, sipas rastit;
    - vii) programet e përdorimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, bazuar në nenet 30-36 të ligjit, sipas rastit;
    - viii) planin për zbatimin e PDV-së – ndërtimin e infrastrukturave dhe shërbimeve publike, sipas parashikimeve të PPV-së.
  - b. Rregulloren e planit të detauar, ku përfshihen:
    - i. përkufizimet e termave të përdorur;
    - ii. shpjegimi i kodeve të përdorura;
    - iii. rregullat, të dhënat dhe kushtet e zhvillimit për çdo nënënjësi, duke detauar rregullat e paracaktuara për njësinë në PPV, sipas shtojcës II në fund të kësaj rregulloreje;
    - iv. rregulla për ndarjen dhe bashkimin e parcelave, sipas rastit;
    - v. rregulla për zbatimin e instrumenteve për drejtimin e zhvillimit sipas neneve 30-36 të ligjit, sipas rastit;
    - vi. kushtet dhe rregullat teknike për zbatimin e infrastrukturave;
    - vii. rregullat për distancat, përcaktimi i vijës së kuqe dhe, sipas rastit, vijës blu; viii) rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit;
    - viii. rregullat e ruajtjes së zonave, objekteve të trashëgimisë kulturore, sipas rastit;
    - ix. rregulla arkitektonike;

- x. rregulla për përshtatjen e hapësirave për personat me aftësi të kufizuar.
  - c. Informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS, në përputhje me standardin e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit.
3. Dokumenti i planit të detajuar vendor shoqërohet nga një dokument teknik i shpërndarjes së balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.


Neni 72, përcakton përsa i përket miratimit të PDV si më poshtë vijon:

1. Procesi i miratimit të planit të detajuar vendor (PDV) bëhet në përputhje me përcaktimet e neneve 22 e 25 të ligjit.
2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e PDVsë është kryetari i bashkisë, në përputhje me shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 13 të ligjit.
3. Kryetari i bashkisë merr vendimin për miratimin e planit të detajuar vendor, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar palët e interesuara përmes RKPT-së, faqes zyrtare të bashkisë, si dhe një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe, në rast se kërkohet, kryen takime publike me ta.
4. Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në reportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit.
5. Në rast se ka kundërshtime si më sipër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore organizon takime publike me palët e interesuara, shqyrton vërejtjet ose propozimet përkatëse dhe vlerëson reflektimin e tyre në planin e detajuar vendor.
6. Në përfundim të procesit, kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit, duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të deponuara.
7. Dokumenti i planit të detajuar vendor hyn në fuqi me botimin e plotë në Registrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimit të miratimit nga kryetari i bashkisë dhe dokumenteve përbërëse të PDV-së.

Harta 2- Harta e perdonimit te tokes per njësine Strukturore 1/55 sipas PPV



Harta 3 – Harta e Njësise Strukturore 1/55, sipas sistemit GIS



3-Parashikimet e PPV për njësinë strukturore 1/55

Paraporta nr.	156
Kodi	155
Emergjimi	PA
Superfice (m <sup>2</sup> )	38075.9
Perimeter (m)	859.3
Përdorimi (K.Bazë) ekz.	A. Banim, S. Shershne, M. Trubetzi i she Monumenet Kulturore dhe Historike, IS. Institucione, AS. Arsim, ZN. Infrastrukturë
I (m <sup>2</sup> /m <sup>2</sup> )	0.50
KSHI (%) ekz.	35%
KSHR (%) ekz.	17%
KSHP (%) ekz.	35%
Kapaciteti mbajtës	4107
Nr. përdoruesve të shërbimit 15-10 m <sup>2</sup> /përdorues	0 - 0
Përdorimi (K.Bazë) prop.	01. Banim
% KAT1	100
% KAT2	0
% KAT3	0
Përdorime të tjera të lejara	Të gjitha aso që nuk janë të ndaluar
Përdorime të ndaluar	Industri dhe Ekonomi përvetësuaritave me produkte jo ndotëse. Ushtria. Përdorime të veçanta që nuk i shërbejnë ose nuk përpunohen përdorimet e propozuara, përvetësuarit e kushtsuara
Përdorime të kushtsuara	Plani e karburantit janë përdorim i kushtsuar me lejohet ndletimi i rrymës së tij/ë distancës së tij vepër, se 50m. Kullë
Tipologjia	21. Niv. 3
Mënyrat e ndërtimit:	Sipas PDV
Parcela minimale (m <sup>2</sup> )	Sipas legjelacionit planit dhe kësaj tregullimit
Distanca (m)	4
I max. (m <sup>2</sup> /m <sup>2</sup> ) KAT1	0
I max. (m <sup>2</sup> /m <sup>2</sup> ) KAT2	0
I max. (m <sup>2</sup> /m <sup>2</sup> ) KAT3	0
KSHI max (%) KAT1	30.00%
KSHI max (%) KAT2	0.00%
KSHI max (%) KAT3	0.00%
KSHP min (%)	35.00%
KSHR min (%)	20.00%
Sip. Parkimi (m <sup>2</sup> )	34840.7
Gjellberimi (2.2m <sup>2</sup> / banor)	10.269
Gjellberimi i përgjithshëm (9 m <sup>2</sup> / banor)	36561.0
I shëves me kushtë (m <sup>2</sup> /m <sup>2</sup> )	2
Lartësi max (m) (jo I me kusht)	53
Lartësia max. (kate) (jo I me kusht)	15
PDV	PO
Sip. Min. pér PDV (m <sup>2</sup> )	11000
Plan rrugor para lejes	PA
Institucione zviceriane	ZNK
Kushte për infrastrukturën, shërbimet dhe të tjera	Ndeshjet e propozuara janë: Restaurimi, Intensifikimi dhe Restrukturimi

### 3- Gjendja e Pronësisë dhe Informaliteti

Bazuar në të dhënat e PPV rezulton se sipërfaqja e përgjithshme e njësisë është 36.075.9 m<sup>2</sup>. Në këtë njësi kemi të bëjmë me një përzierje midis pronave publike dhe private. Tabela e mëposhtme jep shumatoren e përgjithshme të situatës së pronësisë qe perfshihen ne kete PDV:

Harta 4 - Përbledhje e Pronësisë



#### 4- Plani i Veprimeve për Hartimin e PDV-se 1/55

Nr.	Hapat	Përgjegjësitet	Janar [javet]	Shkurt [javet]	Març [javet]	Prill [javet]	Maj [javet]
			2	3	4	5	6
1. Hartimi i Nismës Njeza M55	Raimond Haxhalla						
1.2. Botim i Vendimit të Kryetarit për Nismën e PDV	Ellera Zhupa						
2. Krimimi Databazës							
2.1. Rilevimi Topografik	Matam Gega						
2.2. Pronësia në Zonë	Madilo Gega						
2.3. Projekti Infrastrukturore (ujësjellës, energjikë, telekomunikacion, transport)	Madilo Gega						
2.4. Ndërmjetet në Zonë	Klaid Haxhijaqeni						
2.5. Vlerësimi Mjedisor aktual	Ishu, Mëdhi						
3. Analiza për PDV	Grupe i punes						
3.1. Sella dhe Analizimi i tregueseve të zhvillimit nga PPy	Grupe i punes						
3.2. Analizimi i infrastrukturave ekzistuese	Grupe i punes						
3.3. Analizimi i aksezeit, lëvizjes dhe transportit	Grupe i punes						
3.4. Analizimi i ciliçisë së strukturave dhe territorit	Grupe i punes						
3.5. Analizimi i ofrimit të shërbimeve publike	Grupe i punes						
3.6. Kapacitetet mbajtëse të zonës	Grupe i punes						
3.7. Analiza hapësinore e zonës	Grupe i punes						
3.8. Analizimi i aktorëve të përshtës	Grupe i punes						
3.9. Analizë social-ekonomike e zonës	Grupe i punes						
3.10. Analizë mbi pronësinë	Grupe i punes						
3.11. Database GIS gjendeje aktuale	Specialist GIS						
3.12. Dëgjëse Publike	Grupe i punes						
<b>4. Propozimet e PDV</b>							
4.1. Koncept zhvillimi i zonës	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.2. Plan i detajuar i përdorimit të tokës	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.3. Plani teknik i shtrirje së infrastrukturave të propozuara	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.4. Tipologjia e ndërtueve të propozuara	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.5. Vlerësimi i Noktimit ne Medio	Ishu, Mëdhi						
4.6. Programi i zbatimit	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.7. Konsiderata e të ndikimit soc-ek nga zhvillimi i propozuar	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.8. Plan i shpërndarjez së tregueseve të zhvillimit	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
4.9. Përgatitja e hartave	R.Haxhalla, K.Haxhijaqeni						
<b>5. Studimi i Fizibilitetit</b>							
5.1. Analiza Financiare	Ekonomi						
5.2. Plani teknik i ndarjes/banikimit të parcelave	R.Haxhalla, S.Haja						
5.3. Analizë kosto-përfitim për çdo aktor të përshtës	Ekonomi						
5.4. Instrumentet Financiare për Zhvillimin e Tokës	R.Haxhalla, Ekonomi						
<b>6. Miratimi</b>							
6.1. Dëgjëse Publike	Grupe i punes						
6.2. Reflektimi i komenteve dhe rekomandimeve	Grupe i punes						
6.3. Miratimi final	Kryetari Bashkisë						
6.4. Database GIS perfundimtare	Specialist GIS						
6.5. Botim ne Regjistr	Ellera Zhupa						
<b>7. Zbatimi dhe Monitorimi</b>	R.Haxhalla, Ekonomi						

#### 5- Buxheti për Hartimin e PDV-se 1/55

Hartimi i PDV do të kryhet me nismë publike dhe do të kryhet nga stafi i bashkisë, përkushtuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Drejtoria e Detyrave të Projektimit, Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.

**6- Grupi punës për Hartimin e PDV-se 1/55**

Grupi punës për hartimin e kësaj PDV-je do të përbëhet nga:

Ark. Raimond Hazballa,  
Ark. Klajd Haxhihyseni,  
Ark. Madielo Gega.  
Ing. Top. Eduart Blloshmi  
Ing. Top. Maksim Gega  
Ing. Top. Fatjona Boja  
Ing. Mqedisi  
Ekonomist kostoist  
Jur. Silvi Harja  
Specialist GIS

Monitorim i procesit te hartimit dhe miratimit te PDV-se, nga AKPT.

**DREJTORI I DREJTORISE SE PLANIFIKIMIT TERRITORIT**

Ark. Raimond Hazballa

**DREJTOR DREJTORISE SE PERGJITHESHME E SHERBIMEVE OPERACIONALE**

Ing. Etleva Kenuti